



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463/01-98156, dt. 30 Dhjetor 2024.

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjën në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, neni 4, neni 5 paragrafi 1.2, neni 6 dhe neni 8 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - *Parcela Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri*, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 30 Dhjetor 2024, nxjerr këtë:

**VENDIM
Nr. 73/2024**

Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - Parcela Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri

I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale - parcela komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri në afat prej pesëmbëdhjete (15) viteve sipas Vendimit Nr. 71-2023 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024, me nr. Prot. 463-01/117215. dt. 28 Dhjetor 2023.

| Nr. | PRONARI Poseguesi | Nr. i Ngastrës | Emri i rrugës (lokacioni) | Sipërfaqja | Zona Kadastrale | Destinimi | Përiudha |
|-----|----------------------|-------------------|------------------------------|----------------------|--------------------|------------|----------|
| 1. | Komuna Pejë | 00167-41 | Fsh.Lutogllavë | 10085 m ² | ZK Lutogllavë | Deponi-Dru | 15 vite |

II. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni për komunal për vlerësimin e ofertave do të inicioj procedurën e tenderimit – ankandit publik, për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale - parcela komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri në afat prej pesëmbëdhjete (15) viteve.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlerësuese, Drejtoria për Çështje Pronëso-ro-Juridike.

IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

